



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror
Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit
Mbledhja nr. 49
Prishtinë, më 30.1.2019, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Frashër Krasniqi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Shkumbin Demaliaj, Bilall Sherifi, Xhevahire Izmaqu dhe Jelena Bontiq, si dhe deputeti Nait Hasani.

Mungoi: Sami Kurteshi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Shaban Murturi, Eusr/Euo; Arbisa Shefkiu, Kallxo.com; Gëzim Shala, IKD; Blerta Bejtullahu, EUO/EUSR; Valdete Berisha, Arbresh.info; Nora Kelmendi, Ekonomia online, Arton Konushevci, REL.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

Nga stafi mbështetës: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin nr. 06/L-111 për pagat në sektorin publik;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin nr.06/L-114 për zyrtarët publikë;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin nr.06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi Hajdar Beqa njoftoi anëtarët e komisionit se si zëvendëskryetar i parë i komisionit, ka kërkuar nga kryetarja e komisionit, znj. Albulena Haxhiu, që të mbajë mbledhje të komisionit. Meqë nuk ka pasur vullnet nga kryetarja që të thërrasë mbledhje, ai tha se është bërë kërkesa sipas Rregullores së Kuvendit me 1/3 e deputetëve, ku edhe është ftuar kjo mbledhje.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi konstatoi se rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

Pas miratimit të rendit të ditës, në mbledhje u paraqit kryetarja e komisionit, znj. Albulena Haxhiu. Kryesuesi Hajdar Beqa, tha se meqenëse ftesës së komisionit iu përgjigj edhe kryetarja e komisionit dhe anëtari nga Lidhja Demokratike, z. Arben Gashi, tani i takon që mbledhjen ta udhëheqë kryetarja, me pikat tjera të rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin nr.06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019

Kryetarja, paraqiti para anëtarëve të komisionit, raportin me amendamente në Projektligjin nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019 dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen, nëse kanë vërejtje.

Arben Gashi, tha se paaftësia e koalicionit qeverisës për miratimin e buxhetit sipas afateve ligjore dhe nënshtrimi i presioneve dhe shantazheve politike për të marrë veprimet paraprake për buxhetin, është një veprim i gabuar, dëmton rëndë demokracinë në Kosovë dhe po ashtu bie ndesh me parimet kushtetuese për qeverisje efikase. Qeveria e Kosovës dhe mazhoranca politike e kontestuar, me paaftësinë për të marrë vendim për ligjin kryesor që ka të bëjë me qeverisjen, siç është Ligji për buxhetin, është dëshmi se jemi në një situatë fragile politike, ku rrezikohet efektshmëria e institucioneve të Kosovës.

Kryetarja paraqiti qëndrimin e Lëvizjes Vetëvendosje për buxhetin e vitit 2019, ku dha edhe një mori vërejtjesh si vijon: ky buxhet nuk është buxhet i zhvillimit, nuk është buxhet i luftimit të varfërisë, por është buxhet i asfaltit; ky buxhet nuk garanton përparim të shëndetësisë, por as të arsimit; nuk është ndarë buxhet për avancimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës; nuk ka projekte zhvillimore, po ashtu ka tkurrje të ndihmës sociale; nuk ka ulje të papunësisë, pastaj ky buxhet e mbështet luksin e Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe Presidentit; nuk e adreson ligjin për lehonat, ashtu siç ka premtuar ministri i Punës dhe Mirëqenës, që do të ndahen 100 euro për të gjitha lehonat; nuk adresohen shtesat për fëmijë, po ashtu nuk adreson as kërkesat e grevistëve. Gjithashtu, theksoi se amendamentet e komisionit për legjislacion për agjencitë/institucionet që bien në fushëveprim të komisionit nuk janë përkrahur si tërësi, është përkrahur vetëm një amendament për Agjencinë Kundër Korrupsionit, gjë që është e padrejtë. Në këtë kuptim, nuk mund ta përkrah buxhetin, theksoi deputetja Albulena Haxhiu.

Frashër Krasniqi, tha se partia Socialdemokrate, tashmë veç ka dhënë qëndrim për buxhetin. Ai shtoi se vendi ku duhet të flitet për aspektet përmbajtjesore është seanca e Kuvendit ose Komisioni për Buxhet, ndërsa Komisioni për Legjislacion ka përshkrimin e detyrave në raport me ligjet të cilat vijnë nga komisionet tjera që të konstatojë nëse ligjet janë në shpërputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet tjera.

Xhevahire Izma, tha se duke qenë e pranishme gjatë trajtimit të amendamenteve mund të them se më shumë ka pasur amendamente të deputetëve nga opozita, që janë përkrahur, sesa të deputetëve të shumicës, prandaj mendoj se nuk qëndron ajo që u tha, që buxheti nuk është ndarë në mënyrë të drejtë.

Hajdar Beqa, theksoi se sa i përket raportit me amendamente për Projektligjin e buxhetit të vitit 2019, tha se nuk pajtohet me deputeten Albulena Haxhiu, kur thotë se buxheti bie ndesh me Kushtetutën. Gjithashtu, tha se nëse ka hasur diku në shkelje të Kushtetutës, mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Ai shtoi se do t'i japë mbështetje edhe në emër të Partisë Demokratike këtij rekomandimi me amendamente.

Bilall Sherifi, tha se duke ditur që është konsumuar debati në lexim të parë për buxhetin, tani duhet të shihet vetëm këndvështrimi kushtetues. Ai, duke iu referuar kryetares së komisionit, e cila tha se buxheti bie ndesh me Kushtetutën, i rekomandoi që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Më pas, deputeti Bilall Sherifi kishte pyetje për znj. Haxhiu: meqë kishte shumë vërejtje në Projektligjin për buxhet edhe për jotransparencë, si arriti t'i kuptojë të gjitha këto informata, kur dihet se jotransparenca është kur nuk mund të kesh qasje në një dokument?

Meqë nuk kishte diskutime tjera, kryetarja konstatoi se me shtatë vota "për", komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019 dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.
3. **Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin nr. 06/L-111 për pagat në sektorin publik**

Kryetarja paraqiti vërejtjet e saj në Projektligjin për pagat, ku tha se kanë të bëjnë me Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe Shërbimin Korrektues. Më pas, znj. Haxhiu tha se së fundmi janë miratuar një sërë ligjesh, që i japin kompetenca Agjencisë Kundër Korrupsionit, d.m.th. kësaj agjencie veç po i shtohen kompetencat, ndërsa në Projektligjin për pagat janë ndryshuar shtesat e zyrtarëve në vetëm 20%, gjë që është gabim. Në lidhje me këtë, ajo shtoi se kjo agjenci ka vetëm 40 zyrtarë dhe duhet të shkohet me maksimum të shtesave, sepse nëse ky ligj hyn në fuqi, zbriten paga e tyre. Në këtë drejtim, si Komision për Legjislacion, duhet të bëjmë diçka, në mënyrë që këta zyrtarë të mos kenë ulje të shtesës në pagë.

Xhevahire Izmaku, tha se vota e përfaqësuesit të Vetëvendosjes ka qenë për largimin e kësaj shtese dhe për kategorizimin e nivelit të drejtuesit të kësaj agjencie në një shkallë shumë më të ulët sesa e parasheh Ligji i protokollit. Kam qenë unë që kam ngritur çështjen që duhet patjetër të kenë shtesa këta zyrtarë, edhe pse nuk është votuar deri në atë masë sa është kërkuar. Ndërsa, sa i përket shtesave, ajo tha se tek kategoritë që kanë përcaktueshmëri me grada, rritja është deri në 50%.

Frashër Krasniqi, ngriti çështjen për krijuesit dhe performuesit e kulturës dhe të artit, të cilëve me Projektligjin për paga i përgjysmohet paga e cila ka qenë e rritur me një vendim të ministrisë, ku edhe ministri është drejtuar me një shkresë, ku kërkohet që pagat të jenë ashtu si kanë qenë me vendim. Ai propozoi që projektligji të kthehet në Komisionin për Administratë Publike, por

nëse është e mundur që brenda seancës të shtohet ndonjë amendament, atëherë Komisioni për Legjislacion duhet ta ngre çështjen edhe të Agjencisë Kundër Korrupsionit, edhe çështjen e krijuesve dhe performuesve të kulturës dhe artit.

Hajdar Beqa, paraqiti shkresën e ministrit të Kulturës dhe Sportit, z. Kujtim Gashi, ku është kërkuar rishqyrtimi i koeficientit për krijuesit dhe performuesit e kulturës, meqë në Ligjin për pagat kanë ulje të pagës. Ai tha se duhet të përkrahet kjo kategori dhe të shikohet mundësia që çështja të adresohet në Komisionin për Administratë apo në seancë plenare.

Arben Gashi, tha se është praktikë e gabuar nëse vendoset që në seancë të ndryshohen amendamentet. Si komision, duhet t'i rekomandojmë komisionit funksional, që të rishqyrtojë shqetësimin e agjencive, të cilat bien në fushëveprimin e komisionit e jo të bëhen ndërhyrje në seancë, sepse do të priset komplet skema e ligjit.

Shkumbin Demaliaj, tha se meqenëse si komision nuk iu kemi drejtuar me asnjë amendament as me rekomandim Komisionit funksional, në lidhje me këto kërkesa, ai tha se si komision mund t'i drejtohem seancës me rekomandim për votim ose mosvotim.

Korab Sejdiu, tha se analiza duhet të kufizohet për këtë çështje, si komision jofunksional, d.m.th. të shikohet kushtetutshmëria dhe përputhja me ligje tjera. Ai shtoi se këto çështje që po trajtojmë mund të kenë implikime shumë serioze, në aspektin e barazisë para ligjit, ndarjes së pushteteve e tjera, prandaj nuk është në rregull që të merret vendim për, kundër apo abstenim, pa pasur mundësi kohore që të analizohen këto çështje, që pastaj të merret vendimi adekuat kur dihet se këto janë çështje shumë të rëndësishme dhe jetike për vendin.

Nait Hasani, tha se komisioni për Administratë Publike ka amendamentuar tri projektligjet në pako dhe puna që ky komision ka bërë është që asnjë nga këto ligje të mos bien në kundërshtim me njëra-tjetrën. Ai tha se janë marrë modele të ligjeve që ka Kuvendi i Kosovës, Ligjin e protokollit, për të realizuar një objektiv, që t'iu ikim pakënaqësive dhe kërkesave të individëve që të gradohen në pozita të ndryshme. Në vazhdim, deputeti Hasani tha se Komisioni për Legjislacion mund të japë vërejtjet e veta, ku do të shqyrtohen nga Komisioni për Administratë dhe të përgjigjemi prapë, nëse do të ketë nevojë.

Kryetarja përsëriti se shtesa e zyrtarëve në Agjencisë Kundër Korrupsionit është e papranueshme, që të jetë vetëm 20%. Ajo propozoi që kjo shtesë të jetë të paktën 30 ose 40%.

Nait Hasani, tha se Agjencia Kundër Korrupsionit hulumton zyrtarët publikë, të cilët nuk paraqesin rrezikshmëri për zyrtarët e agjencisë, prandaj paga e tyre është fikse, ndërsa punën që bëjnë jashtë orarit ata marrin shtesën prej 20% dhe shtesa më shumë se kaq do të ketë implikim buxhetor, që nuk mund të përballohet nga shteti.

Kryetarja, tha se ka marrë një shkresë nga Inspektorati i Policisë, ku kanë shprehur pakënaqësitë e tyre, në lidhje me uljen e pagës më shumë se 30%, dhe në lidhje me këtë, kërkoi nga deputeti Nait Hasani, që të japë sqarime.

Nait Hasani, sqaroi se Inspektorati i Policisë e ka koeficientin 2.75, që do të thotë se kanë rritje të pagës, pra nuk qëndron deklarata e tyre, ndërsa sa i përket gardianëve, ai tha se janë trajtuar me status të veçantë, sikurse policia dhe zjarrfikësit.

Kryetarja, tha se po ashtu ka propozuar një amendament, sa i përket Shërbimit Korrektues, ku për shkak të rrezikshmërisë, të kenë shtesa të posaçme, deputeti Nait Hasani u përgjigj, duke thënë se kjo shtesë është përfshirë në ligj, ndërsa propozimi për bashkëpunëtorët profesionalë, deputetja Haxhiu tha se ka kërkuar koeficient 5, ndërsa është përkrahur koeficienti 3.5, gjë që edhe me këtë koeficient iu rritet paga, theksoi znj. Haxhiu.

Korab Sejdiu, tha se pa u trajtuar të gjitha shqetësimet që aktualisht ekzistojnë në shoqërinë tonë, lidhur me të gjitha çështjet që kanë buruar nga kjo temë, nuk mund të marrim vendim dhe nuk mund të votoj diçka të tillë. Më tej, tha se Qeveria do të kishte më shumë sukses, nëse do ta tërheq këtë projektligj në tërësi, në mënyrë që ta ripërpunojë, duke i marrë parasysh të gjitha kërkesat.

Kryetarja ngriti çështjen e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, duke kërkuar sqarim në lidhje me pagën e tij, ndërsa deputeti Nait Hasani dha sqarim për këtë çështje.

Meqë nuk kishte diskutime tjera, kryetarja konstatoi se me shumicë votash, komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr. 06/L-111 për pagat në sektorin publik dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

2. I rekomandohet Komisionit funksional, që në amendamentin 18, fjalët: “përfitojnë shtesë deri 20%”, të zëvendësohen me fjalët: “përfitojnë shtesë deri 30%”.

3. I rekomandohet Komisionit funksional, që t’i rishikojë koeficientet për krijuesit, performuesit dhe punonjësit profesionalë të trashëgimisë kulturore.

4. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t’i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin nr.06/L-114 për zyrtarët publikë

Kryetarja paraqiti para deputetëve raportin me amendamente në Projektligjin nr.06/L-114 për zyrtarët publikë dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen, nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk kishte diskutime, kryetarja konstatoi se me shumicë votash, komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.06/L-114 për zyrtarët publikë dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

2. I rekomandohet Komisioni funksional, që amendamenti 78 të harmonizohet me dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

3. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin nr.06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura

Kryetarja ngriti si shqetësim se shumë agjenci të pavarura, të cilat i raportojnë Kuvendit, kanë marrë vendim që të raportojnë në Qeveri. Lidhur me këtë pikë, deputetja Albulena Haxhiu kërkoi sqarim nga z. Nait Hasani, se pse është marrë një vendim i tillë, kur kjo është gabim.

Nait Hasani, duke iu përgjigjur deputetes Haxhiu, tha se në listën që kemi, janë 65 agjenci ekzekutive dhe të pavarura, ku është kërkuar që të trajtohen në projektligj, ndërsa Ministria e Administratës Publike ka kërkuar që me një ligj të veçantë do te rekomandojë, ku do të barten këto agjenci. Pra, tani për tani këto agjenci do të mbesin si janë tani, deri në strategjinë që do të vijë nga ministria, theksoi deputeti Nait Hasani.

Meqë nuk kishte diskutime tjera, kryetarja konstatoi se me shumicë votash, komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

2. I rekomandohet Komisioni funksional, që amendamenti 32 të harmonizohet me dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

3. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Të ndryshme

Në këtë pikë nuk kishte diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 15:20.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Albulena Haxhiu